


## Stratigrafia e zonës Jonike



Në ndërtimin e zonës Jonike marrin pjesë një bashkësi e gjerë shkëmbinjsh sedimentarë të cilët në kohë dhe hapësirë pësojnë ndryshime litologjike dhe faciale.

Duke u bazuar në këto veçori, zonën Jonike e ndajmë në këto formacione shkëmbore: halogjene, karbonatike, flishore e flishoidale, paramollasike dhe mollasike.

### Litologjia dhe Fauna e formacionit karbonatik

**Triasik i sipërm.** Dolomite masivë gri me thjerza dolomitësh brekçoze. *Thecosmilia norica*.

**Lias i poshtëm (J<sub>1</sub><sup>1</sup>).** Gëlqeror gri dhe të errët, shtresë mesëm dhe të trashë, Dolomite me thjerza dhe shtresa stralli. Gëlqeror dolomitik me alge. (*Involutina liasica*, *Thaumaporella*.)

**Lias i sipërm (J<sub>1</sub>).** rreshpe me posidonia, gëlqeror me amonite. (*Posidonia buci*)

**Jurasik i mesëm (J<sub>2</sub>).** Facie karbonatore me straje të rralla dhe me alge pejzore. Pako e poshtme stralore me shtresa gëlqerori argjilor. (*Posidonia buci*, *P. bronii*)

**Jurasik i sipërm. (J<sub>3</sub>).** Pako e sipërme stralore. Straje të shpeshta të errët, të ndërthurur me gëlqeror argjilor. (*Lamemmaptychus gr. saccocoma*).

**Jurasik i sipërm-kretak i poshtëm (titonian-hoterivian).** Gëlqeror porcelanik me tintinide dhe nyje stralli.

**Kretak i poshtëm.** Gëlqeror me ticinella me nyje stralli, poshtë rreshpe argjilore, gëlqeror argjilor me hedbergella. (*Ticinella roberti*, *Calpionellopsis*).

**Kretak i sipërm.** Copa rudistësh, poshtë fosforite. (*Rotalipora appeninic*).

**Senonian (kretak i sipërm).** Gëlqeror gri-roze me globotruncana dhe horizont gëlqerori turbidikë. (*Globotruncana stuarti*).

**Paleocen (Pg<sub>1</sub>).** Shtresa gëlqerori me straje të rralla, horizonte turbidik. (*Globotruncana velsconensis*).

**Eocen (Pg<sub>2</sub>).** Gëlqeror me straje të rralla e horizonte me foraminifer. (*Globorotalia*).

**Oligocen (Pg<sub>3</sub>).** Flish.